

VENDIM
Nr. 458, datë 10.6.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E FAKTORËVE DHE TË SITUATAVE QË MERREN
PARASYSH NË VLERËSIMIN E RREZIQEVE TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE
FINANCIMIT TË TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4/2, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton faktorët tregues të situatave me risk të ulët të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, për të cilat mund të zbatohet vigjilenca e thjeshtuar.

2. Ky vendim zbatohet për vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, që lidhen me llojin e klientëve, të zonës gjeografike, të produkteve, të shërbimeve, të transaksioneve apo të kanaleve të veçanta të shpërndarjes, në rastet e zbatimit të vigjilencës së thjeshtuar.

3. Faktorët tregues të riskut të ulët përfshijnë, si më poshtë vijon:

a) Faktorët e riskut që lidhen me klientin:

i. kompanitë publike të listuara në tregje titujsh dhe që u nënshtrohen rregullave të transparencës (sipas rregullave të tregut të titujve apo nëpërmjet ligjit apo të mjeteve të tjera të detyrueshme), që vendosin rregulla për transparencën e pronarëve përfitues;

ii. ndërmarrjet apo administratat publike.

b) Faktorët e riskut që lidhen me produktet, transaksionet, shërbimet apo kanalet e shpërndarjes janë:

i. policat e sigurimit të jetës me prim të ulët;

ii. policat e sigurimit në skemat e pensionit pa mundësi përfitimi të parakohshëm dhe polica nuk mund të përdoret si kolateral;

iii. skemat e pensionit të zakonshëm, të pensionit suplementar apo të përfitimeve të tjera të ngjashme, të cilat sigurojnë përfitime për punonjësit pas daljes në pension, kur kontributet zbriten nga paga dhe rregullat e skemës së pensionit nuk lejojnë transferimin e së drejtës;

iv. shërbime apo produkte financiare, të cilat sigurojnë shërbime të kufizuara dhe të përcaktuara shprehimisht për kategori të caktuara klientësh, me qëllim përfshirjeje financiare;

v. produkte ku risqet e pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit menaxhohen nga faktorë të tjerë.

c) Faktorët gjeografikë të riskut janë:

i. vendet e vlerësuara si vende me sisteme efektive kundër pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit;

ii. vende të identifikuara, nga burime të besueshme, si vende me nivele të ulëta të korrupsionit apo të veprimtarive të tjera kriminale;

iii. vende, të cilat, sipas burimeve të besueshme, si raporte të përbashkëta të vlerësimit, raporte të hollësishme të vlerësimit apo raporte të publikuara të vëzhgimit, kanë kërkesa për luftimin e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e rishikuara të grupit të posaçëm të veprimit financiar dhe i zbatojnë efektivisht ato kërkesa.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, autoritetet mbikëqyrëse e licencuese, si dhe subjektet raportuese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama